


# DISA KËSHILLA

## SI TË MENAXHOSH FINANCAT PERSONALE NË KOHË KRIZE!

Sikurse e gjithë bota, edhe qytetarët e Kosovës janë duke u ballafaquar me pandeminë globale. Kriza ka krijuar rrethana të reja për të gjithë ne, duke ndikuar në aspektin social, profesional dhe financiar. Qytetarët përveç tjerash duhet të ballafaqohen edhe me sfidën e menaxhimit të duhur të financave personale apo të bizneseve të tyre.

Qytetarët duhet të jenë më të kujdesshëm si asnjëherë më parë në marrjen e vendimeve për financat e tyre, ku përveç mbrojtjes së shëndetit si masë primare, të marrin vendime sfiduese për financat e tyre dhe nëse është e mundur të kursejnë një pjesë të të hollave të tyre.

Ballafaqimi me krizën, ka nxjerrë në pah shumë faktorë që ndikojnë në mirëqenien financiare e që janë jashtë kontrollit individual. Njohuritë e përgjithshme financiare, mund t'iu ndihmojnë njerëzve t'i menaxhojnë më mirë financat e tyre gjatë kohërave të vështira.



# DISA KËSHILLA

Si të menaxhosh financat personale në kohë krize!

## 1 Shqyrtojeni buxhetin tuaj/mundësitë tuaja financiare

Bëni kujdes të vazhdueshëm ndaj buxhetit tuaj (mjeteve tuaja financiare) që keni në dispozicion në këto rrethana. Jepini përparësi nevojave bazike si: ushqim, ngrohje, energji elektrike, ujë, e gjëra të tjera të domosdoshme të cilat ju nevojiten gjatë kësaj periudhe.



# DISA KËSHILLA

Si të menaxhosh financat personale në kohë krize!

## 2

Shqyrtojeni  
shpenzimet  
tuaja

Disa gjëra për të cilat ju keni shpenzuar (p.sh investime kapitale të cilat mund të shtyhen për një periudhë më të përshtatshme, daljet me shoqëri, shkuarjen në pushime, reduktimi i shpenzimeve të transportit, blerjet e gjërave të luksit, etj), gjatë kësaj periudhe mund të mos i bëni. Rrjedhimisht bëni përpjekje që këto të holla t'i kurseni ose reduktoni në masë të tillë që nuk e pengon buxhetin e nevojave bazike.





# DISA KËSHILLA

Si të menaxhosh financat personale në kohë krize!

3

**Shiko masat ekonomike të  
ndërmarra nga Qeveria e  
Republikës së Kosovës**

Shiko nëse kualifikoheni në ndonjërin pjesë të pakos emergjente të miratuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Nëse po, shiko udhëzimet dhe procedo sipas udhëzimeve.



# DISA KËSHILLA

## Si të menaxhosh financat personale në kohë krize!

### 4 Shiko mundësinë për shtyerje të Kredisë

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës për shkak të gjendjes së krijuar në vend dhe rënies së nivelit të të hyrave të konsumatorëve të cilët nuk kanë mundësi të bëjnë pagesën e këstit të kredisë së tyre, ju mundësohet pezullimi dhe ristrukturimi i pagesave të kësteve të kredisë. Rrjedhimisht nëse keni nevojë për më tepër kohë dhe nuk keni mundësi ta paguani këstin, rishikojeni Kredinë që e keni dhe komunikoni me bankën në të cilën e keni marrë kredinë, që ta bëni zhvendosjen e këstit për më vonë. Ju mund ta kontaktoni bankën tuaj përmes telefonit apo postës elektronike (emailit), pa pasur nevojë, që të shkoni në bankë. Ju duhet të përgatiteni që t'i sqaroni bankierit situatën tuaj (gjendjen tuaj financiare), ku punoni apo ku keni punuar, si dhe arsyen pse ju nuk do të mund ta bëni pagesën këtë muaj. Pezullimi i pagesave të kësteve nënkupton që ju, lirohenivetëm nga pagesa, interesat ndëshkuese dhe klasifikimi kreditor për periudhën në fjalë dhe jo nga obligimet tjera kontraktuale.

Për sqarim: Interesi ndëshkues nuk është norma e interesit të kredisë, për të cilën jeni dakorduar por është interes që njëra nga palët kontraktuese penalizohet si pasojë e mos përmbushjes së kontratës dhe kjo duhet të jetë e shpalosur si informatë edhe në kontratën tuaj.



# DISA KËSHILLA

Si të menaxhosh financat personale në kohë krize!

## 5 Paguaj me Kartelë apo E-Banking

Mënyra më e shpejt dhe me e lehtë që ofron siguri në kohë pandemie është pagesa përmes e-Banking dhe mundësia e dytë është ajo me kartelë. Pagesa përmes e-Banking eliminon kontaktet fizike gjë që është rekomanduar edhe nga OBSH<sup>[1]</sup>. Nëse paguani me e-banking, rekomandohet tashmangni përdorimin e shërbimit e-Banking në kompjuterë publik apo WI-FI publike. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, po bën dezinfektimin e të gjitha të hollave që dalin në qarkullim, megjithatë ato qarkullojnë nëpër gjithë vendin dhe nëpër njerëz e vende të ndryshme, prandaj është mënyra më e sigurt që pagesat të bëhen me e-banking apo me kartelë.

<sup>[1]</sup>Organizata Botërore e Shëndetësisë





# DISA KËSHILLA

Si të menaxhosh financat personale në kohë krize!



**Bisedoni për  
paranë me  
familjarët tuaj**

Bëni plane afatshkurta, afatmesme pse jo edhe afatgjate për financat e familjes. Pandemia ka ndikuar që familjet të kalojnë më shumë kohë së bashku,

Rekomandohet që pjesë e diskutimeve familjare të jetë edhe menaxhimi i parave dhe kursimet.



# DIËA KËSHILLA

Si të menaxhosh financat personale në kohë krize!

## 7 Krijo një fond emergjence

Fillo të kursesh 10, 20 euro, 50, 100 apo 200 euro, aq sa ju lejojnë mundësitë tuaja, por filloni menjëherë, me pranimin e pagës, mundohuni të ndani për kosto mujore sipas nevojave të domosdoshme, pastaj një pjesë ndajeni për fondin emergjent dhe më pas për shpenzime tjera sipas mundësive.





# DISA KËSHILLA

Si të menaxhosh financat personale në kohë krize!

## 8

**Mbaj nën kontroll shpenzimet me kredit kartelë**

Disa qytetarë të cilët kanë kredit kartela, mendojnë t'i shfrytëzojnë ato si fond emergjent, por mos harroni se këto kartela kanë interes, prandaj pse të paguajmë interes, gjithmonë mendoni për alternativën e parë, që do të thotë t'i kursejmë të hollat dhe t'i kemi në llogarinë tonë të hollat dhe pa paguar interes.

